



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:245083
Datë: 19.11.2024
Numri i dokumentit: 06476705

K.DH.SH.II.nr.2072/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Faton Bajrami dhe Dren Rogova, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Sallahu shpk me NUI:81035237 me seli në Kaçanik, të cilin e përfaqëson me autorizim avokate Bahrije Besimi nga zyra e avokatisë ABV Law Firm në Prizren, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.443/24 të datës 01.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit -propozuesit Sallahu shpk me NUI:81035237 me seli në Kaçanik, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.443/24 i datës 01.10.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, është Refuzuar si e pabazuar kërkesa e

paditësit/propozuesit Sallahu shpk me NUI:81035237 me seli në Kaçanik, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit OSHP: 2024/0555 datës 31.07.2024, të paditurit të dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit, Njoftimit për dhënie të kontratës dt.11.06.2024 dhe vendimit datës 21.06.2024 të paditurit të parë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë,

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësueses së autorizuar, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar, të Ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.443/24, ashtu që të aprovohet në tërsi si i bazuar propozimi i paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurës Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik OSHP:2024/0555 dhe Njoftimit për dhënien e kontratës dhe vendimi i datës 21.06.2024 i të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, deri në vendosjen meritore nga gjykata.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësit, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP 2024/0555 datës 31.07.2024 i nxjerr nga i padituri i dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik me seli në Prishtinë, Njoftimit për dhënie të kontratës dt.11.06.2024 dhe vendimit datës 21.06.2024 të paditurës së parë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të kontestuar, të përcaktuar në nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së. Paditësi nuk e ka provuar se do të shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm nëse ekzekutohet vendimi i goditur. Pjesëmarrja në një aktivitet të prokurimit nuk nënkupton apriori shpalljen si tenderues fitues, rrjedhimisht nuk ka asnjë garanci për tu shpallur tenderues i suksesshëm në një

aktivitet të prokurimit. Gjykata rikujton se shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ të goditur do të nënkuptonte ndalimin e procedurës së prokurimit publik deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, gjë që për gjykatën do të ishte në kundërshtim me interesin publik, pasi që përmes kësaj procedure synohet të realizohet zgjerimi i rrugës nacionale N9-segementi Kijevë deri në Dollc për lot 1, nga e cila do të përfitonin banorët e atij regjioni. Gjykata nuk mund të lëshohet në vlerësimin e pretendimeve faktike dhe juridike që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e aktit administrativ të cilat paditësi i ka paraqitur në padi.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që: *shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji i Dhomave të shkallës së dytë, gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP:2024/0555 datës 31.07.2024 i nxjerr nga i padituri i dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik me seli në Prishtinë, si dhe Njoftimin për dhënien e kontraës dt.11.06.2024 dhe vendimit dt,21.06.2024 të paditurës se parë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paditurës. Meqë në këtë rast paditësi, në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme pretendimin, se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së, prandaj, pretendimet ankimore të paditësit se ekzekutimi i vendimit kontestues dëmton interesat dhe të hyrat materiale të paditësit, se paditësi nuk do të mund të

zhdëmtohet në mënyre të arsyeshme përmes kompensimit financiar për dëmet dhe humbjet që do ti shkaktohen si rezultat i vazhdimit të procedurës së rivlerësimit, Kolegji i vlerësoi këto pretendime ankimore të pabazuara dhe të pa argumentuara, duke konkluduar se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë. Kolegji vlerësoi se pretendimet ankimore janë tërësisht të mbështetura në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata e shkallës së parë, do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Pretendimet tjera ankimore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, Kolegji i vlerësoi si tërësisht të mbështetura në deklaratat të paargumentuara, dhe në këtë rast paditësi nuk ka paraqit dëshmi se si ka ardhur deri të dëmi i shkaktuar me ekzekutimin e vendimit të paditurave, ashtu që ekzekutimi i vendimit kontestues do ti shkaktonte dëm të pariparueshëm.

Kolegji pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm, se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, apo kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata e Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të propozimit të paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të paditurave, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit, Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.2072/24 datë 18.11.2024

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha